



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRIN	
01 Nr. / Br	81 / 21
Nr. i fq. / Br. st	- 2 -
Data: / Datum	16. 04. 2021
VESHTRRI - VUÇITRIN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19 paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 11 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159, nenit 22 paragrafi 1 i Rregullores (QRK) NR.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 41, paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në rekomandimin e Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 31 mars 2021, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **16 prill 2021**, merr këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimtarive biznese, si vijon:

- 2.1. Solid Group SH.P.K.;
- 2.2. Druri SH.P.K.;
- 2.3. B.t.p. Holding SH.P.K.;
- 2.4. Timber Home SH.P.K.;
- 2.5. Time N.T.P.;
- 2.6. Unikonzum;
- 2.7. Mateo Company SH.P.K.;
- 2.8. Homestar N.T.P.;
- 2.9. Vazo SH.P.K.;
- 2.10. Bunsam Metal SH.P.K.;
- 2.11. Euro Driloni;

- 2.12. Bina SH.P.K.;
- 2.13. Ra Eximp SH.P.K.;
- 2.14. Emona Center SH.P.K.;
- 2.15. Berto SH.P.K.;
- 2.16. Te Duli D.P.Z.;
- 2.17. Trios Group SH.P.K.;
- 2.18. Bvd Ing. SH.P.K.;
- 2.19. AH Invest SH.P.K.;
- 2.20. Ajna Cake SH.P.K.;
- 2.21. Union SH.P.K.;
- 2.22. 7 Vëllezërit SH.P.K.

3. Bizneset e cekura si në pikën paraprake, në tri në 3 vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m² në vit.

4. Prona e paluajtshme e komunës iu jepet në shfrytëzim subjekteve ekonomike në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve.

5. Obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë kontratë me secilin përfaqësues të biznesit të cekura në pikën 2 (dy) të këtij vendimi.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: rekomandimi i komisionit vlerësues dhe dokumentacioni shtesë i paraparë me legjislacionin në fuqi.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

8. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit